



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 31

Datë 18 mars 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 8513 datë 6.3.2014	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	723
Dekret nr. 8514 datë 7.3.2014	Për emërimin e rektorit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.....	723
Vendim i KM nr. 110, datë 27.2.2014	Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2015-2017.....	723
Vendim i KM nr. 114, datë 5.3.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, të ndryshuar.....	725
Vendim i KM nr. 115, datë 5.3.2014	Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil.....	728
Vendim i KM nr. 116, datë 5.3.2014	Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.....	730
Urdhër i ILDKP nr. 29, datë 17.3.2014	Për një ndryshim në urdhrin nr. 620, datë 22.11.2012 “Për miratimin e llojeve të deklaratës së interesave privatë”	731

Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Astrit Banushaj.....	732
Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Bardhul Musaj.....	732

DEKRET

Nr. 8513, datë 6.3.2014

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Gjyste Marian Dashi
2. Latif Abdulah Abdulahi
3. Fatma Ruşen Aga (Duman)
4. Sofia Odhiseas Shima (Nika)
5. Lukë Martin Tahiri
6. Halit Murat Bajraktaraj
7. Merita Adem Jusufi (Sejdiu)
8. Mahmut Cem Ali Ihsan Çenkoğlu
9. Agron Muhamed Podrimaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8514, datë 7.3.2014

PËR EMËRIMIN E REKTORIT NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

Në mbështetje të nenit 92, shkronja "g" dhe nenit 93 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", të ndryshuar, si dhe të nenit 23, pika 2 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të ministrit të Arsimit dhe Sportit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Prof.dr. Ali Refatllari emërohet në postin e autoritetit drejtues, rektor, në Universitetin e Mjekësisë Tiranë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM

Nr. 110, datë 27.2.2014

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE
PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE TË
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
2015-2017

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2015-2017, sipas lidhjes nr.1 "Tavanet e ministrive dhe institucioneve buxhetore", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Të gjitha ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore, brenda datës 21 mars 2014, të depozitojnë në sistemin e thesarit limitet e angazhimeve të tyre trevjeçare për periudhën 2015-2017, përkatësisht në masën:

a) 30 për qind të fondit të mbetur, pas zbritjes nga taveri i zërit "Shpenzime të tjera korrente, i kontratave ekzistuese të lidhura në këtë zë;

b) 50 për qind të fondit të mbetur, pas zbritjes nga taveri i zërit "Shpenzime kapitale të brendshme", i kontratave ekzistuese të lidhura në këtë zë.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimit përkatës të procedurave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohen të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr.1

Tavanet e Ministrive dhe Institucioneve Buxhetore, në milion Lekë

	viti 2015				viti 2016				viti 2017			
	600-601	602-606	230-231	Transferim për Fondet Speciale +ISKSH+KP	600-601	602-606	230-231	Transferim për Fondet Speciale +ISKSH+KP	600-601	602-606	230-231	Transferim për Fondet Speciale +ISKSH+KP
	Paga-Sig.sh oq.	Te tjera Korente	Investime/brendshme huaja		Paga-Sig.sh oq.	Te tjera Korente	Investime/brendshme huaja		Paga-Sig.sh oq.	Te tjera Korente	Investime/brendshme huaja	
1 Presidencia	100	72	5	177	100	76	5	181	100	76	5	181
2 Kuvendi	600	381	49	1,030	600	400	49	1,049	600	400	49	1,049
3 Kryeministria	225	234	60	519	225	246	60	531	225	246	60	531
4 Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes	435	272	182	1,889	435	286	182	1,903	435	286	132	1,853
5 Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave	1,753	3,180	925	7,859	1,753	3,350	925	8,029	1,753	3,350	425	7,529
6 Ministria e Transportit dhe Infrastrukturs	435	2,057	10,818	42,235	435	2,280	9,471	35,616	435	2,280	5,886	30,931
10 Ministria e Financave	3,291	2,057	467	6,315	3,291	2,160	467	6,617	3,291	2,160	367	6,517
11 Ministria e Arsimit dhe Sportit	30,711	7,234	2,330	42,274	30,911	8,195	3,830	44,936	31,211	9,587	2,000	48,735
12 Ministria e Kulturës	884	359	164	1,406	884	377	164	1,424	884	377	164	1,425
13 Ministria e Shëndetësisë	3,134	1,704	790	32,864	3,182	2,784	790	26,678	3,379	2,878	1,400	27,419
14 Ministria e Drejtësisë	3,555	1,019	919	6,193	3,555	1,070	919	6,244	3,555	1,070	300	400
15 Ministria e Punëve të Jashtme	878	1,257	18	2,153	878	1,320	18	2,216	878	1,320	18	2,216
16 Ministria e Brendshme	13,314	3,529	800	18,043	13,314	3,705	800	18,219	13,314	3,705	320	17,739
17 Ministria e Mbrojtjes	6,067	4,887	1,500	12,454	6,067	4,526	1,500	12,093	6,067	4,078	1,000	11,145
18 Shërbimi Informativ Shtetëror	1,004	382	50	1,436	1,004	401	50	1,455	1,004	401	50	1,455
19 Drejtoria e Radio Televizionit	0	357	0	357	0	375	0	375	0	375	0	375
20 Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	134	28	5	167	134	29	5	168	134	29	5	168
22 Akademia e Shkencës	239	55	2	89	32	58	2	92	32	58	2	92
24 Kontrolli i Lartë i Shënit	239	81	20	340	239	85	20	344	239	85	20	344
25 Ministria e Mirënjohjes Sociale dhe Rinisë	1,151	24,286	249	76,687	1,151	24,387	249	50,992	1,151	25,975	199	80,189
26 Ministria e Mbrojtjes	921	236	343	2,001	921	248	350	2,019	921	248	220	1,889
28 Prokuroria e Përgjithshme	1,120	295	135	1,550	1,120	309	135	1,564	1,120	309	135	1,564
29 Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	1,594	319	140	2,052	1,594	335	140	2,068	1,594	335	140	2,068
30 Gjykata Kushtetuese	80	26	4	110	80	28	4	112	80	28	4	112
31 Agjencia Telegrafike Shqiptare	77	15	1	93	77	16	1	94	77	16	1	94
40 Partitë Politike	0	200	0	200	0	200	0	200	0	200	0	200
50 Instituti Statistikë	365	117	7	489	365	123	7	495	365	123	7	495
55 Shkolla e Magjistraturës	29	30	1	60	29	31	1	61	29	31	1	61
56 Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	0	1,270	5,770	0	0	1,250	5,750	0	0	1,000	5,500
57 Qendra Kombëtare e Kinematografisë	9	93	2	104	9	98	2	109	9	98	2	109
63 Këshilli i Lartë i Drejtësisë	64	27	2	93	64	28	2	94	64	28	2	94
66 Avokati i Popullit	76	16	4	96	76	17	4	96	76	17	4	96
67 Komisioni i Shërbimit Civil	33	11	2	45	33	12	2	46	33	12	2	46
73 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	68	617	3	688	68	620	3	691	68	635	3	706
76 Inspektorati i Lartë i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive	74	26	4	104	74	27	4	105	74	27	4	105
77 Autoriteti i Konkurrencës	52	10	1	63	52	11	1	64	52	11	1	64
78 Ministria e Integritimit Evropian	101	49	38	438	101	52	38	440	101	52	38	440
82 Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	8	4	1	13	8	4	1	13	8	4	1	13
87 Institucione të tjera Qeveritare	281	592	331	1,204	281	621	320	1,223	281	621	200	1,103
88 Agjencia për Mbrojtjen e Shqetësive Civile	14	106	1	121	14	111	1	126	14	111	1	126
89 Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	33	13	1	47	33	13	1	47	33	13	1	47
91 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	27	10	1	38	27	11	1	38	27	11	1	38
92 Instituti i Studimit të Krimeve të Komunizmit	18	13	1	32	18	13	1	32	18	13	1	32
93 Ministria e Energjisë dhe Industrisë	431	367	150	948	431	385	150	966	431	385	100	916
94 Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	574	656	492	1,722	570	666	500	1,736	570	666	202	1,438

VENDIM
Nr. 114, datë 5.3.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË
VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE
CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT
DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË
KRYEMINISTRIN, APARATET E MINISTRIVE
TË LINJËS, ADMINISTRATËN E
PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT
QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË
E PËRGGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË
PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË
KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË
VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE
ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2 të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj” dhe të ligjit nr. 185/2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

I. Në pikën 1/3 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “a”:

- emërtesa “Drejtorja e Përgjithshme e Inspektoratit Shtetëror të Punës” zëvendësohet me “Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në nivel qendror”;

- shtohet emërtesa “Agjencia Kombëtare e Bregdetit”.

2. Në shkronjën “b”:

- emërtesa “Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar” zëvendësohet me “Inspektorati Shtetëror i Arsimit”;

- shtohet emërtesa “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”.

3. Në shkronjën “c”:

- emërtesa “Drejtorja e Shërbimeve të Midhjes dhe Peshkimit, Sarandë” zëvendësohet me “Drejtorja e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës;

- emërtesa “Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve” zëvendësohet me “Agjencia Kombëtare e Mjedisit”.

II. Në lidhjen 3/1, emërtesa “Kordinator në Departamentin e Administratës Publike” shfuqizohet.

III. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“3/1. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës në Departamentin e Administratës Publike të jenë sipas lidhjes 3/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

IV. Në fund të pikës 6 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Titullari i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ka të drejtë të ketë një këshilltar të jashtëm. Paga e tij mujore është sipas kategorisë III-a.”.

V. Lidhja nr. 7/1 (pjesa I dhe II), që përmendet në pikën 11/1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

VI. Lidhja nr. 9, që përmendet në pikën 13, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga momenti i emërimit të nëpunësve.

KRYEMINISTRIN
Edi Rama

Lidhja nr. 3/2

**KATEGORITË E PAGAVE TË POZICIONEVE TË PUNËS NË DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS
PUBLIKE**

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Drejtor i Departamentit të Administratës Publike	I-b	1
Drejtor drejtorie	II-b	1
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist i nivelit të lartë	III-b	1 ose 2
Specialist i nivelit të mesëm	IV-a	1 ose 2 ose 3
Specialist	IV-b	1 ose 2 ose 3

I. PËR TEATRIN KOMBËTAR, SI DHE DREJTORINË E OPERËS DHE FILARMONISË DHE DREJTORINË E BALETIT NË TEATRIN KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr.	Pozicioni	Paga
1	Drejtori i Operës dhe Filarmonisë Dirigjent (orkestre) Dirigjent (baleti) Regjisor Solist i parë (lirik, baleti) Koncertmaester Baletmaester Aktor i parë	79.200 lekë
2	Spala sektori (orkestre)	76.000 lekë
3	Solist II (lirik, baleti, pianist) Spalë sektori (kori)	73.200 lekë
4	Asistent dirigjent Asistent regjisor Aktor i dytë Orkestrant i kategorisë së parë Dirigjent kori	71.000 lekë
5	Orkestrant i kategorisë së dytë	68.500 lekë
6	Solist i tretë (lirik, baleti)	63.000 lekë
7	Korist i kategorisë së parë Balerin i kategorisë së parë Skenograf i kategorisë së parë Pianist korepetitor	59.800 lekë
8	Aktor i tretë Korist i kategorisë së dytë Pianist përgatitor Balerin i kategorisë së dytë	58.300 lekë
9	Skenograf i kategorisë së dytë	49.500 lekë

II. PËR DREJTORINË ARTISTIKE TË ANSAMBLIT TË KËNGËVE DHE VALLEVE POPULLORE NË TEATRIN KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR, TRUPËN ARTISTIKE TË TEATRIT TË KUKULLAVE NË QENDRËN KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË, TEATRIN KOMBËTAR TË KOMEDISË DHE CIRKUN KOMBËTAR

Nr.	Pozicioni	Paga
1	Drejtor i Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore Mjeshtër vallesh (korepetitor) Dirigjent Regjisor Drejtues artistik	71.000 lekë
2	Solist i parë Orkestrant i kategorisë së parë Aktor i parë Skenograf i kategorisë së parë Korist i kategorisë së parë Valltar i kategorisë së parë Akrobat i kategorisë së parë Mjeshtër i studios së cirkut Mjeshtër profili i numrave të cirkut	59.800 lekë
3	Orkestrant i kategorisë së dytë Valltar i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë	57.800 lekë
4	Solist i dytë Aktor i dytë Skenograf i kategorisë së dytë Akrobat i kategorisë së dytë Orkestrant i kategorisë së tretë Valltar i kategorisë së tretë Korist i kategorisë së tretë	49.500 lekë

Lidhja nr. 9

KATEGORITË E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET RAJONALE/VENDORE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT, MINISTRAVE TË LINJËS, TË INSTITUCIONEVE RAJONALE/VENDORE NË VARËSI TË INSTITUCIONEVE TË PËRCAKTUARA NË PIKËN 1 TË INSTITUCIONEVE VENDORE NË VARËSI TË INSTITUCIONEVE RAJONALE, TË PUNONJËSVE QË KRYEJNË FUNKSIONE TË DELEGUARA TË PUSHTETIT QENDROR NË PUSHTETIN VENDOR, TË BORDEVE TË KULLIMIT, TË KOMISIONEVE VENDORE TË SHQYRTIMIT TË VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE, PRANË PREFEKTIT TË QARKUT

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Titullar i institucionit rajonal Kryetar i Zyrës së Përmbaramit Drejtor i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Përgjegjës i degëve të Thesarit në qendër qarku Përgjegjës seksioni në seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qarqe Kryeinspektor në inspektoratet e mbrojtjes së tokës në qarqe	III-b	1
Titullar i institucionit vendor Përgjegjës i zyrës rajonale Përgjegjës sektori në institucionet rajonale Përgjegjës sektori në Drejtoritë e Bujqësisë Përgjegjës sektori në Degën e Thesarit Tiranë Përgjegjës të degëve vendore të Thesarit Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar) Përgjegjës i gjendjes civile pranë prefektit Inspektor të sistemit të Ministrisë së Bujqësisë	IV-a	1
Përmbarues gjyqësor në zyrat e përmbaramit gjyqësor Specialist në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Specialist në degët rajonale të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit	IV-a	1 ose 2 ose 3
Përgjegjës sektori i institucionit vendor Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në komuna (si funksion i deleguar)	IV-b	1
Specialist i zyrës së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar) Specialist në Drejtoritë e Bujqësisë Specialist i gjendjes civile pranë Prefektit Specialist në institucionet rajonale Restaurator arti Arkitekt Inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës në qarqe Specialist në degët e Thesarit Inspektor pune	IV-b	1 ose 2 ose 3
Specialist në institucionet vendore Specialist i zyrës së gjendjes civile në komuna (si funksion i deleguar) Restaurator Instruktor Piktor Kontrollor pune	IV-c	1 ose 2 ose 3

VENDIM
Nr. 115, datë 5.3.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
DISIPLINORE DHE TË RREGULLAVE PËR
KRIJIMIN, PËRBËRJEN E VENDIMMARRJEN
NË KOMISIONIN DISIPLINOR NË SHËRBIMIN
CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 59, pika 10, e 69 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë procedurën disiplinore dhe rregullat për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil.

KREU I
ORGANET DISIPLINORE

1. Organet disiplinore, sipas ligjit, janë: Komiteti Kombëtar i Përzgjedhjes, për anëtarët e TND-së (KKP); komisioni disiplinor (KD), për nëpunësit e tjerë, dhe eprori direkt.

2. Komisioni disiplinor, për institucionet e administratës shtetërore, përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka këtë përbërje:

a) nëpunësin më të lartë civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore, i cili kryeson komisionin;

b) eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;

c) drejtuesin e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ku bën pjesë nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;

ç) një përfaqësues të DAP-it;

d) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore.

3. Për institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet, komisioni disiplinor përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka përbërjen e mëposhtme:

a) nëpunësin më të lartë civil në atë institucion;

b) eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;

c) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për atë institucion;

ç) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;

d) nëpunësin më të vjetër civil të njësisë ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore.

4. Për komunat, komisioni disiplinor përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe ka këtë përbërje:

a) nëpunësin më të lartë civil në atë institucion;

b) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për atë institucion;

c) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore.

5. Komisioni disiplinor mblihdhet, organizohet dhe funksionon në bazë të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale.

6. Në rast të lindjes së nevojës së zëvendësimit të anëtarëve të KD-së, për arsye të pamundësisë apo pengesës ligjore, zbatohen dispozitat për zëvendësimin, të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

7. Në rast se ecuria disiplinore zhvillohet për një nga anëtarët e KD-së, ai zëvendësohet nga titullari i institucionit me një tjetër nëpunës civil të institucionit.

KREU II
PROCEDURA DISIPLINORE

1. Me “procedurë disiplinore” do të kuptohet gjithë veprimtaria administrative, që kryhet që nga momenti i konstatimit të një shkeljeje disiplinore, vënies në dijeni, me shkrim, të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga organi disiplinor.

2. Nëpunësit e institucionit, kur kanë dijeni apo dyshojnë për shkelje disiplinore, të kryera nga nëpunës të tjerë të të njëjtit institucion, duhet t’ia raportojnë atë, me shkrim, eprorit direkt të nëpunësit për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen.

3. Kur shkeljet janë konstatuar nga shtetas apo institucione jashtë strukturave të institucionit ku bën pjesë nëpunësi për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen, ato i raportohen zyrtarisht institucionit përkatës.

4. Ankesa/rekomandimi në lidhje me shkeljen disiplinore të pretenduar, sipas pikave 2 dhe 3 të kreut II të këtij vendimi, duhet të plotësojë këto kushte:

a) të jetë me shkrim;

b) të identifikojë nëpunësin civil, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen disiplinore;

c) të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij.

5. Kërkesat anonime nuk pranohen për shqyrtim.

6. Ankesa/rekomandimi i depozituar në institucion, sipas pikës 3 të kreut II të këtij vendimi, i dërgohet eprorit direkt të nëpunësit të cilit i atribuohet shkelja.

7. Eprori direkt, në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore nëpërmjet ankesave nga publiku, e vlerëson paraprakisht atë.

8. Nëse informacioni i marrë nuk rezulton të ketë elemente që mund të klasifikohen si shkelje disiplinore, eprori direkt vendos të mos e fillojë ecurinë disiplinore.

9. Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente të klasifikuara si shkelje disiplinore, eprori direkt bën klasifikimin e shkeljeve sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013.

10. Në rast se shkelja klasifikohet në shkeljet e lehta, eprori direkt fillon ecurinë disiplinore. Në rast të kundërt, eprori direkt i kërkon KD-së të fillojë ecurinë disiplinore.

11. Në rast se eprori direkt vihet në dijeni për një shkelje disiplinore nga subjektet e përcaktuara në shkronjën "b" të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 152/2013, eprori direkt fillon menjëherë ecurinë disiplinore ose, nëse nuk është kompetent për shqyrtimin e saj, ia përcjell informacionin KD-së.

12. Nëse shkelja që i atribuohet nëpunësit, rezulton se nuk është klasifikuar drejt apo nuk është në juridiksionin lëndor të organit disiplinor që e ka marrë në shqyrtim kërkesën, atëherë ai vendos dërgimin me shkresë zyrtare pranë organit kompetent.

13. Në rastin e marrjes dijeni për një shkelje disiplinore, organi disiplinor fillon ecurinë disiplinore dhe njofton, me shkrim, nëpunësin përkatës:

- a) për shkeljen disiplinore të pretenduar për të;
- b) për të drejtën që ai ka për të paraqitur, me shkrim, sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar dhe afatin deri kur duhet të paraqitet ky sqarim;
- c) për të drejtën që ka për të inspektuar dosjen e procedimit, për t'u dëgjuar, ai vetë apo me përfaqësues ligjor, për të paraqitur dëshmitarë, për të paraqitur prova ose për të kërkuar marrjen e tyre;
- ç) për datën kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar. Kjo datë nuk mund të caktohet më shpejt se 4 (katër) ditë dhe jo më vonë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë nga marrja e njoftimit nga nëpunësi.

14. Organi disiplinor heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit, si dhe mund të përdorë çdo mjet për të mbledhur prova, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, e, në veçanti, ai kryen veprimet e mëposhtme:

- a) pyet ose merr deklaratat nga dëshmitarët dhe verifikon faktet kundërshtuese;
- b) rishikon dokumentacionin përkatës për mospërputhje, për fakte që mungojnë, data apo firma që janë hequr etj.;
- c) shqyrton dosjen e nëpunësit;
- ç) thërret nëpunësin për t'u njohur me variantin e tij të ngjarjeve apo të problemit;
- d) verifikon praktikën dhe rastet e procedimeve disiplinore të mëparshme;
- e) kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes.

15. Në përfundim të hetimit administrativ, sipas pikës 14 të kreut II të këtij vendimi, organi disiplinor i vë në dispozicion nëpunësit që po procedohet materialet e mbledhura gjatë këtij hetimi.

16. Në seancën dëgjimore nëpunësi paraqitet vetë ose cakton një përfaqësues, sipas ligjit. Në rast se pas dy njoftimeve të njëpasnjëshme, nëpunësi apo përfaqësuesi i tij nuk paraqiten, ecuria disiplinore vazhdon në mungesë.

17. Organi disiplinor, pasi shqyrton çështjen sipas pikave 13, 14 dhe 15 të këtij vendimi, dhe pasi ka dëgjuar nëpunësin përkatës ose përfaqësuesin e tij ligjor, apo vë në dukje, me shkrim, mosparaqitjen e tij, megjithëse nëpunësi ka marrë dijeni rregullisht, vendos marrjen e masës disiplinore ose ndërprerjen e ecurisë disiplinore.

18. Vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore merret nga organi disiplinor në rastet kur:

- a) nuk ka shkelje disiplinore, siç ishte menduar;
- b) rezulton se nëpunësi nuk ka kryer shkelje me faj;
- c) veprimi nuk ka qenë ose nuk është kryer nga nëpunësi përkatës.

19. Vendimi përfundimtar i organit disiplinor përmban këto të dhëna:

- a) organin që ka marrë vendimin;
- b) identifikimin e nëpunësit ndaj të cilit është marrë masa;
- c) masën e marrë;
- ç) shkeljen faktike;
- d) bazën ligjore;
- dh) arsyetimin e vendimit dhe shpjegimin e fakteve që janë bërë shkas për marrjen e vendimit;
- e) rastet e mëparshme të shkeljeve të ngjashme dhe të masave disiplinore të marra;
- ë) një listë dhe kopje të të gjitha dokumenteve që mbështesin masën disiplinore të dhënë, nëse këto kërkojnë nga nëpunësi nën procedim;
- f) të drejtën që ka nëpunësi i ndëshkuar për t'u ankuar dhe afatet e ankimit.

20. Një kopje e vendimit, së bashku me materialet shoqëruese, u jepen nga organi disiplinor nëpunësit dhe njësisë përgjegjëse, brenda 4 (katër) ditëve nga dhënia e tij. Kopja e vendimit bëhet pjesë e dosjes personale të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 116, datë 5.3.2014

**PËR STATUSIN E NËPUNËSVE DHE
PUNONJËSVE AKTUALË QË PËRFITOJNË
STATUSIN E NËPUNËSIT CIVIL SIPAS LIGJIT
NR. 152/2013 “PËR NËPUNËSIN CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 8 të nenit 67 dhe të nenit 69 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

**STATUSI I ANËTARËVE TË TND-së NË
INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS
SHTETËRORE**

1. “Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues”, në Kryeministri, aparatit e një ministrie apo titullarët e institucioneve të varësisë së Kryeministrit apo ministrit, të pranuar në shërbimin civil sipas procedurave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, janë, për shkak të ligjit, anëtarë të TND-së.

2. DAP-i verifikon procedurën e rekrutimit për nëpunësit, sipas pikës 1 të kreut I të këtij vendimi, dhe lëshon për çdo nëpunës aktin e deklarimit të statusit të punësimit sipas ligjit nr. 152/2013, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Statusi, të drejtat dhe detyrimet e titullarëve të institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrit, të cilët nuk janë rekrutuar sipas procedurave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, deri në përfundimin e procedurës së pranimit në TND, rregullohen sipas legjislacionit në bazë të të cilit ka lindur marrëdhënia e tyre e punës.

KREU II

**STATUSI I NËPUNËSVE TË TJERË CIVILË NË
INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS
SHTETËRORE, INSTITUCIONET E PAVARURA,
BASHKITË DHE QARQET**

1. “Nëpunës civilë”, sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione në shërbimin civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

2. DAP-i, për institucionet e administratës shtetërore, apo njësia përgjegjëse, për institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet, verifikon procedurën e rekrutimit dhe lëshon për çdo nëpunës aktin e deklarimit të statusit të punësimit, sipas ligjit nr. 152/2013, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

KREU III

**STATUSI I PUNONJËSVE EKZISTUES NË
INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS
SHTETËRORE DHE KOMUNAT**

1. “Punonjës ekzistues”, sipas pikës 3 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, që kryejnë funksione të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore e komuna, dhe:

a) janë rekrutuar sipas procedurave të ngjashme me ato të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, por që nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil; apo

b) janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se një vit, janë nëpunës civilë për shkak të ligjit.

2. “Punonjës ekzistues” që mbajnë një pozicion të konsideruar si pjesë të shërbimit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, në institucionet e administratës shtetërore e në komunë dhe që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më pak se një vit, janë nëpunës civilë në periudhë prove. Periudha e provës fillon nga data e fillimit të efekteve të ligjit.

3. Në rastin e institucioneve të administratës shtetërore, njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë çdo institucioni, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dërgojnë në institucionin qendror nga varen listën e plotë të nëpunësve, së bashku me dosjen përkatëse, ku përfshihen akti i emërimit, kohëzgjatja e periudhës së punësimit, dokumentacioni që vërteton procedurën e marrjes në punë, si dhe dokumentet personale të punonjësve.

4. DAP-i, për institucionet e administratës shtetërore, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja e dokumentacionit të mësipërm, bën verifikimin, rast pas rasti, të plotësimit të kriterëve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të kreut III të këtij vendimi, dhe në përfundim vendos:

a) deklarimin e statusit të punësimit;

b) kthimin e dokumentacionit për plotësim, duke përcaktuar edhe afatin brenda të cilit duhet të plotësohen mangësitë.

5. Në rastin e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 4 të kreut III të këtij vendimi, DAP-i bën deklarimin e statusit të punësimit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e dokumenteve plotësuese.

6. Në rastin kur punonjësit nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, DAP-i njofton njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës, sipas afateve të përcaktuara në pikat 4 dhe 5 të kreut III të këtij vendimi.

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës.

7. Në rastin e komunave, njësia përgjegjëse bën verifikimin, rast pas rasti, të plotësimit të kriterëve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të kreut III të këtij vendimi, dhe lëshon për çdo punonjës, të përcaktuar sipas pikave 3 e 4 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, aktin e deklarimit të statusit të punësimit sipas ligjit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Në rastin kur punonjësit nuk i plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civilë, sipas ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës.

KREU IV DISPOZITA TRANSITORE

1. Procedura e deklarimit të statusit të punësimit përfundon jo më vonë se 120 (njëqind e njëzet ditë) ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Në rast se për shkaqe të arsyeshme, procedura nuk ka përfunduar brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të kreut IV të këtij vendimi, DAP-i/njësia përgjegjëse ka të drejtën e shtyrjes së afatit një herë të vetme, jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë.

3. Çdo nëpunës civil/punonjës ka të drejtën të kërkojë deklarimin e statusit të punësimit pranë DAP-it/njesisë përgjegjëse, pavarësisht procedurës së nisur nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës.

4. Nëpunësit civilë, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, parashikuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", dhe që janë në periudhë prove, vazhdojnë periudhën e provës sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj.

5. Procedura e vlerësimit në përfundim të periudhës së provës, për këta nëpunës, bëhet sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

URDHËR **Nr. 29, datë 17.3.2014**

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 620, DATË 22.11.2012 "PËR MIRATIMIN E LLOJEVE TË DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATË"

Në zbatim të nenit 15 germa "a", të nenit 40 pika 1 germa "d" dhe nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, dhe në rregulloren e brendshme të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

Me arsyetimin se:

Me urdhrin nr. 620, datë 22.11.2012 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKP-së "Për miratimin e llojeve të deklaratës së interesave privatë", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 154 të vitit 2012, janë miratuar format e deklaratës së interesave privatë, "Para fillimit të detyrës", "Periodik/vjetor", "Pas largimit nga detyra" dhe "Me kërkesë";

Në faqen 12 të formularëve sipas modelit të miratuar, është përcaktuar dhe mënyra e plotësimit të tyre, me shkrim dore ose në mënyrë elektronike;

Nisur nga fakti se formulari i deklarimit konsiderohet dokument zyrtar dhe duhet të përmbajë të gjithë elementet e një dokumenti zyrtar, duhet të shmanget plotësimi me shkrim dore, duke paraqitur saktësi, seriozitet dhe estetikë,

URDHËROJ:

Në faqen nr. 12 të deklaratës private para fillimit të detyrës, deklaratës së interesave privatë periodik/vjetor dhe deklaratës së interesave privatë pas largimit nga funksioni, bëhet ndryshimi si vijon:

Fjalja "Formulari i deklarimit të plotësohet me shkrim dore ose në mënyrë elektronike, por në çdo rast nënshkruhet me shkrim", zëvendësohet me fjalinë: "Formulari i deklarimit plotësohet vetëm në mënyrë elektronike (me kompjuter)". Pas printimit të formularit të plotësuar sipas kërkesave ligjore, bëhet nënshkrimi për çdo fletë të tij, sipas rubrikave përkatëse.

Zyrtari plotëson dhe nënshkruan dokumentin nga faja 1 deri në faqen 7 të tij.

Personi i lidhur (bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë) plotëson dhe nënshkruan, në rastet si vijon:

a) Kur kanë pasuri të regjistruar veçmas në emër të tyre, plotësojnë në mënyrë elektronike vetëm me kompjuter faqen 7-11;

b) Kur nuk kanë pasuri të regjistruar veçmas në emër të tyre, plotësojnë vetëm faqen nr. 8.

2. Dorëzimi i deklaratës nga zyrtari do të bëhet vetëm në zyrën e autoritetit përgjegjës të institucionit publik ku punon.

3. Bazuar në shkronjën “e”, neni 40 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, mosplotësimi në mënyrë elektronike dhe me kompjuter i deklaratës së interesave privatë para fillimit të punës, deklaratës së interesave privatë periodik/vjetor dhe deklarata e interesave privatë pas largimit nga funksioni, përbën shkelje ligjore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Ganaj

KËRKESË

Shtetasi Tahsim Banushaj, i datëlindjes më 25.11.1951, lindur dhe banues në Vlorë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë shpalljen të vdekur të vëllait të tij, shtetasit Astrit Banushaj.

KËRKUESI
Tahsim Banushaj

KËRKESË

Shtetësja Shpresa Musaj, e datëlindjes 25.4.1940, lindur në Selenicë dhe banuese në Tiranë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj, shtetasit Bardhyl Musaj.

KËRKUESE
Shpresa Musaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 16 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006